

PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 26.10.2023

Kryesuesi i mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 12:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 33

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej këshilltarësh:33

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: zv/kryetari Kletjon Kita

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 2

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 2 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 22- SHTATOR 2023
DHE TE DATËS 12-TETOR 2023

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 3 e rendit të ditës

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1 – 31 SHTATOR 2023.

Këshilltare A.Taho: Përshëndetje të gjithëve, komisioni është mbledhur ditën e hënë me pjesëmarrjen e pothuajse të gjithëve anëtarëve të komisionit, kemi marrë informacionin e duhur nga drejtoria përkatëse kemi nje ulje të numrit te familjeve 61,familje janë tani përfituese nga programi i bllok ndihmës ekonomike, 2 familje të tjera kanë kaluar ne sistemin ndëkombëtar të ndihmës që është pjesë e shërbimit social shtetëror. Nga ky fond përfitojnë famlije të përxgjedhura sipas kriterëve te caktuara janë 28 familje që përfitojne kompesim të energjisë elektrike dhe 15 familje që përfitojnë nga fondi i buxhetitit vendor. komisioni ka qënë plotësisht dakort mendojm tja kalojme këshillit për miratim këtë material.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka nga këshilltaret ?

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 4 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA.

Këshilltare A.Taho: Edhe për këtë çështje komisioni ka menduar ta kalojë në këshill materialin janë 2 familje të cilat janë të specifikuara në material dhe sipas shpjegimit që ka dhënë drejtoria përkatëse,2 familje kanë plotësuar kriteret e vendosura kështu mendojme dhe ky material të kalojë për votim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit,nga këshilltarët ka pyetje nëse jo e hedhim në votim.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 5 e rendit të ditës

MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT, "SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË"

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Meqënëse dhe pika 5 u sqarua paraprakisht nga Anxhela.

Këshilltare A.Taho: Ishte pjesa për 10 familjet por duke qënë se nuk kemi pasur asnjë kundërshtim në komision atëherë dhe ky material kalon për miratim.

Këshilltar D.Osmani: Për ekzekutivin ne lidhje me pikëzimin e këtyre familjeve, sa familje ka pasur gjithsej që kanë aplikuar për këtë fond?

Ekzekutivi M.Balli: Përshendetje në lidhje me përgjigjen e pyetjes tuaj ju them se aplikimi për të plotësuar kushtet janë këto 10 familje ndërkohë që janë 16 familje që janë në plotësim të dokumentacionit sapo të jenë gati do i kalojm për miratim.

Këshilltar D.Osmani: Pra janë 26 familje?

Ekzekutivi M.Balli: Po.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Me të plotësuar dokumentacionin do të kalojnë për miratim pasi janë udhëzuar nga drejtoria për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 6 e rendit të ditës.

PËR RISHPËRNDARJEN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA.

Këshilltare A.Taho: Drejtoria e strehimit ka bërë njoftimin për rishpërndarjen e 3 apartamenteve të lira të banesave sociale me qera ka pasur disa aplikimepor vetëm 3 familje rezultojnë me pikë maksimale në material kanë qënë të specifikuar të gjitha materialet për të 3 familjet komisioni nuk ka pasur asnjë diskutim cdo sqarim i nevojshem është dhënë nga drejtoria përkatëse mendojmë që dhe ky material të kaloj në këshill për votim.

Këshilltar K.Pllaha: Kisha 2 pyetje dhe 1 sygjërim,po i bëj njëkohësisht që mos e mar fjalën 2 herë do të thotë që ka 2 apartamente të lira,kjo është më shumë për statistikë ish banorët e tyre kanë blerë shtëpi të reja janë larguar nga Shqipëria apo nuk kane pasur mundësi të jetojnë me qera.Kane aplikuar 8 familje por mundësia ishte vetëm për këta, ka ndonjë ide se çfarë do të ndodhë me këto 5 familje që i plotësonin kriteret por nuk u pajisën,ka ndonjë program të dytë ndihme për to apo ka ndonjë plan Bashkia te ndërtoje më shumë godina që ti jap me qera dhe

sygjerimi nga ana ime është siç bëhen promovime nga ana e bashkisë për punët e mira që ajo bën mbase do ishte mirë që edhe këto si për kreditë e buta të promovoheshin nëpër mediat sociale ose të shpallehin publikisht kriteret që do të plotësojnë e të tjera.

Ekzekutivi M.Balli: Atëherë në përgjigje të pyetjes të parë këto 3 apartamente që ne arritëm të siguronim në momentim që rinovohet kontrata e qeras erdhën si rezultat i 2 faktorëve, dy të parat që janë apartamente 2 plus 1 në rinovimin e kontratës u kostatua që të ishin fituar banesa në pronësi pra nuk mund të trajtohehin më në strehimin social detyrimisht ata duhet të dorëzonin apartamentet dhe kjo ndodhi, ndërsa apartamenti i 3 është siguruar si rast i shkeljes në të gjitha detyrimet që përcakton kontrata të një familje e cila kishte më shumë se 3 muaj mos pagim të qerasë pasi nga ana jonë u kaluan të gjitha procedurat për ti dhënë mundësi për të bërë pagesen dhe të gjitha afatet që lidhen me këtë procedurë ai nuk tregoi interes dhe ne duhet ta mernim vetë në dorëzim apartamentin, kështu është praktika që ne kemi ndjekur për lirimin e këtyre apartamenteve. Ishte në emigracion në Greqi dhe nuk pranoi të afrohej as për të paguar detyrimet as për tu takuar sepse këto banesa sociale të lëshuar me qera janë fond i Bashkisë Korçë dhe janë fond qarkullues që do të thotë nëse një nga këto familje del nga kriteret, automatikisht duhet ta dorëzojë me vullnetin e saj. Pyetja tjetër në lidhje me aplikimin ashtu si e përcakton dhe ligji ne kemi bërë shpalljen dhe ka një vendim të këshillit bashkiak numër 82 mos gaboj te cilin ne e kemi cituar në relacion i cili buron rishpërndarjen e apartamenteve sepse për shkak të nevojave të mëdha për strehim në ato banesa kemi familje rezidente që jetojnë përtej noramve të strehimit jetojnë në një gazoniere familje me 3 antëtar me 4 anëtar dhe duke qënë dhe pagues të rregullt të qeras ne i kemi parë gjithmonë si një kontigjent për ti zgjeruar për tju dhënë atyre kushte më të mira ata bënë aplikimin plotësuan dokumentat dhe kane qënë 8 aplikantë të cilët arritën të plotësojnë dokumentat por nëpërmjet sistemit të pikëzimit vetëm 3 prej tyre arritën të marrin pikët maksimale të cilë janë pikërisht këta të 3 të cilët ne i paraqesim sot në realcion. Të tjerët do të mbeten si kandidatë primar për ti trajtuar sipas munësive që do kemi në vazhdim.

Këshilltar K.Pllaha: A ka në plan për të shtuar numrin e këtyre godinave apo jo ?

Ekzekutivi M.Balli: Ashtu siç ju thash ky është 1 fond qarkullues kontrata rinovohet çdo vit dhe ne çdo vit kemi mundësi të sigurojmë në projektet e strehimit që ka bashkia patjetër që ka shfaqur interes për të shtuar numrin e banesave sociale por këto janë gjëra që nuk varen totalisht nga ne sepse kanë kosto shumë të lartë është programi i subencioneve të interesave të kredisë kështu që në këtë mënyrë të përpiqemi ti mbështesim.

Këshilltar D.Osmani: Në vazhdim të kësaj pra bashkia nuk ka aktualisht ne projektet e saj ndërtimin e këtyre godinave?

Ekzekutivi M.Balli: Në projektet e saj bashkia ka projekte të tjera dhe kryesisht e ka të dedikuar për një kategori familjesh që nuk realizojnë të ardhura janë familje të strehuara tek ish konviketet dhe ato duke qënë dhe kushtin ekonomik nuk arrijnë ta përmbushin ne kemi një projekt ndërtimin e banesave sociale në një shesh që është pronë e bashkisë aktualisht ne kemi hedhur hapat ligjore për marrjen e këtij e pronësis për dizajnin teknik dhe më pas për të siguruar fonde për zbatimin e këtij projekti.

Këshilltar L.Petri: Unë nuk dua të hy në teknalitete sepse si komisoni si drejtoritë e bëjnë shumë mirë punën sepse kanë vite që e bëjnë këtë gjë kanë vite që e bëjnë këtë gjë por nuk mund të rri pa ngritur një çështje në parim a është konsideruar si nga drejtoria e banesave sociale por edhe nga drejtoria e përgjithshme e burimeve njerëzore apo dhe nga vetë ekzekutivi që këto banesa sociale jo domosdoshmërisht mund të bëhen nga pallate të reja dua të them këtë gjë ne jetojmë në një qytet që po mer vëmendje shumë turizmi dhe turizmi ka të mira por ka dhe anë negative që do të thotë ritet shtrenjtësira e jetës bëhet më e vështirë për të përballuar jetën nga ana tjetër kemi fshatra të cilat po boshtasien, a është konsideruar një skenar që këto banesa sociale jo domosdoshmërisht te ndërtohen nga e para por shtëpitë ekzistuese që janë nëpër fshatra të bëhet një marrëveshje që njerëzit që ndahen nga trangu familjar të jetojn aty dhe të jetë e përballueshme si nga subvencione kredish të buta por edhe nga plolitika sociale të bashkisë.

Ekzekutivi M.Balli: Në lidhje me problemin që shtroni ju, Bashkia Korçë është në një teritor akoma më të gjere përveç qytetit dhe përfshin dhe njësit administrative kështu që patjetër të gjithë kanë të drejtë të aplikojnë për të përfituar banesave sociale të cilat janë të parashikuara në zbatim të ligjit për strehim nga ndryshimi i ligjit për strehim sot kemi 1 mundësi tjetër se përveçse subencionimi i interesave të kredisë mund të shërbejë për blerjen e banesave në treg te lirë mund të shërbejë edhe për ndërtime në troje të cilat mund të jenë pronë private gjithmonë sipas vlerës familjare që i takon aplikantit kjo është një risi që sjell ligji dhe unë e shikoj si një mundësi më të mirë për tju përgjigjut kësaj çështje që ju shtroni me interes.

Këshilltare L.Alidinaj: Kemi drejtoreshën e strehimit ku doja ti drejtohesha me një pyetje a ka ndonjë projekt ide të dy pallateve që janë të këtyre banesave?

Kryetare e Këshillit A.Verushi: E keni çështje tjetër, e hedhim në votim.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Këshilltar D.Osamani: Mos ja hiqni te drejtën e fjalës qytetarëve, duhet ta dëgjojmë.

Kryetare e Këshillit A.Verushi: Nuk po ja heqim të drejtën, fjala për qytetare eshte e miratur dhe nga këshilltarët, është pika në fund.

Këshilltar D.Osamani: Ku shkruhet kjo?

Kryetare e Këshillit A.Verushi: E ke në rendin e ditës.

Pika 7 e rendit të ditës.

PËR PËRCAKTIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR Z.LULËZIM XHINDI , TË CILIT I ËSHTË DËMTUAR BANESA NGA RËNIA E ZJARRIT.

Këshilltar E.Muharem: Përshëndetje komisioni është mbledhur ditën e hënë pasi është njohur me materialin dhe ka marë dhe informacionin e duhur dhe nga ekzektuivi bëhet fjalë për se janë 2 relacione, ne datën 22.09.2023 në banesën e qytetarit Lulëzim Xhindi është ne fshtain Gjonomadh ka rënë zjarr në banesë e cila ka shkaktuar dëme të mëdha edhe në orendi shtëpiake por edhe ne anën strukturore të godinës bazuar ne vendimin e këshillit të ministrave por edhe në ligj ka mundësi dhe për detyrë të mbështesë në anë financiare familjet të cilat ju dëmtohen banesat nga shkaqe natyrore, kështu jemi njohur edhe me materialin ka dy lloj mbështetje ne këtë rast jepet edhe për pjesën e orendive edhe për pjesën e ndërtimit në anën strukturore të objektit vlera e kompesimit e vlerësuar nga specialistët është 268 mijë 996 lekë e 85 qindarka kështu që ne jemi njohur me materialin jemi dakort kështu ja përcjellim këshillit për ta miratuar.

Këshilltar E.bregu: Në dokumentacionin e paraqitur keni pasur ndonjë llogaritje të zërave jo se dua të na e paraqesni ne por thjesht dua ta di ju e keni parë ne komision këtë apo jo?

Këshilltar E.Muharem: Ne e kemi parë atë ditë që ishte komisioni e kishte me vete dosjen.

Drejtori i emergjencave A.Qazolli: Sa herë që ndodh një fatkeqësi natyrore ngrihet një komision përcaktimi me urdhër të kryetari të bashkisë shkon në vend ku ka ekspert nga emergjenca civile dhe urbanistika për gjithë orenditë dhe materialet që janë në këtë banesën ngrihet një procesverbal përcaktimi e miraton kryetari i bashkisë i shkon këshillit të qarkut dhe bën vlerësimin sipas VKM,në bazë të vlerësimit përgatitet relacioni për ju pra është i bazuar në vendimin NR.329 të vendimit të ministrave të 2012,rast pas rasti dhe janë 8 pika që duhet të miratohet.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 8 e rendit të ditës.

PËR PËRCAKTIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR Z.TOMI SOFRONI , TË CILIT I ËSHTË DËMTUAR BANESA NGA RËNIA E ZJARRIT.

Këshilltar E.Muharem: Zonja Kryetare është e njëjta praktikë, zotit Tomi Sofroni i është djegur banesa ne lagjen 12 të qytetit të Korçës vlerësimi janë të njëjta, procedura është e njëjte vlere e dëmit është e përlogaritur në të 2 linjat edhe në pjesen e orendive shtëpiake por edhe në dëmtimi i strukturës të objektit vlere financiare është 779 mijë e 489 lekë e 85 qindarka kështu që e hedh në këshill për miratimin e procedurës e cila është e bazuar në ligj edhe në vendimin e këshillit të ministrave.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 9 e rendit të ditës.

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË TË PASURISË NR.40/4 DHE 40/5 ZONË KADASTRALE 1446 ME SIPËRFAQE 183 M2 TRUALL DHE 107.5 M2 NDËRTESË ME VENDNDODHJE NË DARDHË, NJA DRENOVË, BASHKIA KORÇË SIPAS GENPLANIT BASHKANGJITUR.

Këshilltar K.Kocibelli: Këtu kemi të bëjmë me dy pasuri te cilat ndodhen në fshatin Dardhë dhe janë pronë e shtetiti në vitin 2010 ku Bashkia e Korçë ka mar një listë me prona nuk i është kaluar kjo pronë dhe sipas ligjit 87/44 të vitit 2001 i cili ka të bëjë me transferimin e pronës shtetërore tek njësitë vendore çdo bashki në këtë rast ka të drejtë te kërkojë në pronësi ato prona që janë të shtetit dhe mund ti përdorë për qëllimet e saj në këto kushte edhe komisioni i ligjeve ka vendosur t'ja kalojë këshillit bashkiak për miratim pikën 9 të rendit të ditës.

Këshilltar I.Bode: Në fakt është më shumë për ekzekutivin kjo pyetje lexoj që bashkia Korçë ka për qëllim të realizojë investim nga kjo pasuri ne përmbushje të saj ligjore,ndonjë diçka më konkrete mund të më sqaroni?

Ekzekutivi M.Balli: Mendohet që të jëtë një pikë destinacioni turistik, unë bashkë me një grup këshilltarësh ishim për përzgjedhjen e këshillit të fshatrave, në momentin që ne zgjodhem

këshillat e fshatrave dhe kryepleqtë ne e kemi parë vetë atë ndërtesë të gjithë besoj duhet ta keni parë është ajo godina përballë muzeut e cila nga mbrapa është e rënuar dhe këtu u ngrit te cilët dhe banorët e Dardhës e ngriten si shqetësim sepse ajo po bie e mira është që me marjen nga ana e bashkiës të fillohen punimet ashtu si dhe bashkia ka bërë planet e veta kështu që plotësojmë dhe njërin nga ato kërkesa të komunitetit të Dardhës.

Kryetare e Këshillit A.Verushi: Lazjon ke diçka?

Këshilltar L.Petri: Faleminderit ZNJ.Kryetare pyetja u mbulua nga kolegu paraardhës.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 10 e rendit të ditës.

**PËR MIRATIMIN E FONDIT DHE TË PROGRAMIT PËR REALIZIMIN E VIZITËS
STUDIMORE NGA ANËTARËT E KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË ,
NË BASHKINË E SHKODRËS DHE NË BASHKINË E LEZHËS.**

Kryetare e Këshillit A.Verushi: Siç jeni ne dijëni dy kryetarët e bashkiës Shkodër dhe Lezhë na kanë dërguar një ftesë të cilën po e citoj edhe njëherë.

E nderuar ZNJ.Verushi me porosi të kryetarit të Këshilli Bashkiak Shkodër Oltjon Luli kam nderin që kuadër të konsolidimit të mëtejshem të bashkëpunimit tju ftoj në një takim në Shkodër me qëllim shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet dy institucioneve tona si organe direkte të përfaqësimit të komuniteteve tona. Në këtë kontekst do të çmonim më tepër shkëmbimin e njohurive dhe praktikave të dëgjësive të konsultimit me publikun praktikave të indetifikimit për prioritete dhe investim të dala nga dëgjësia publike,praktika të ndërtimit të mardhënive të këshillit me median dhe publikun praktikave të gërshetimit të punës të këshillit me strukturën komunitare në zonat urbane dhe rurale,praktikat e gjithëpërfshirjes dhe punes te grupeve të marginalizimve ne radhën e punës të këshillit e të tjera iniciativa të ngjashme të dala nga komuniteti dhe përfaqësuesit e tij,është kënaqësia jonë tju kemi të pranishem ju së bashku me të gjithë anëtarët e këshillit bashkiak sipas mundësive dhe anagzimeve tuaja në muajin nëntor 2023 me qëllim shkëmbimin e këtyre praktikave nga 2 palët dhe se çfarë mund të bëjmë më mirë për komunitet që ne përfaqësojm.Po në vijim po ju lexoj dhe ftësën e erdhur nga këshilli bashkiak i Lezhës.

E nderuar ZNJ.Verushi në kuadër të bashkëpunimit profesional kam kënaqësinë tju ftoj për një vizitë dhe qytetin e Lezhës ju dhe të gjithë anëtarët e këshillit si dhe persona të tjerë që punojnë ngushtë në këshillin dhe që mund të përfitojmë nga kjo vizitë është shumë e rëndësishme që të shkëmbejm eksperiencia që kemi në fushën e rritjes të kapaciteteve të këshilltarëve në frocimin e rolit të këshillit për monitoimin e roleve që ofron bashkia apo për mekanizmat e përdorur për të

nxitur pjesëmarjen e publikut apo dhe çështje të tjera që dalin gjatë punës tonë për përafqësimin e qytetarëve respresivë, duke shpresuar që të gjeni mundësinë të jeni në Lezhë në datën 17 nëntor 2023. Duke u nisur nga këto dy ftesa të ardhur dhe meqënëse janë në të njëjtën linjë rrugore të transportit unë kam kthyer një përgjigje pozitive duke adresuar së pari të gjithë këshilltarëve këto ftesa duke kërkuar prej tyre se cilët janë të gatshëm të vijnë dhe njëkohësisht kemi hartuar një plan aktivitetesh të cilat do na shoqërojnë dhe e kemi të lidhur me materialin që do të shoqërojnë këtë aktivitet në këto dy bashki Lezhë dhe Shkodër. Tani fjala është për ju nëse keni diçka për të thënë dhe nëse këshilltarë të tjerë ende nuk e kanë vendosur dhe aprovuar bashkimin me ne në këtë udhëtim janë të lutur sot ta bëjnë sepse do të miratohet nga këshilli numri fizik i këshilltarëve që do të marin pjesë, do ju lutsha këshilltarëve edhe njëherë të shikojnë anagazhimet e tyre dhe do të ishte mirë që ne të gjithë së bashku të ishim në këtë udhëtim.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 33

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kryetare e Këshillit A.Verushi: Kalojmë në pikën 11 të rendit të ditës kërkesa ankesa të qytetarëve fillimisht do ju jap fjalën qytetarëve që ndodhen këtu dhe e kanë ndjekur mbledhjen dhe më pas kemi disa kërkesa të adresuara në këshill të cilat do i trajtojmë më vonë por besoj që do të marin zgjidhje kur të jetë dhe kryetari prezent meqëse ai ndodhet në një vizitë pune në Strasbourg.

Ekzekutivi M.Balli: Fiks kur u bë shpërndarja e banesave me qera, është e vërtetë që ajo është trajtuar me një apartament në katin e 8 të cilin unë nuk jap dot shpjegime pse ka shkuar atje ka erdhur ka lidhur kontratë në atë banesë ne kemi ashensor dhe fëmija që është djali i rritur në fakt që është me aftësi të kufizuara kjo është e vërtetë duhet të ngjiste një numër shkallësh për të aritur deri tek kati i 8. Gjithmonë kemi qënë të hapur ta dëgjojmë në të gjitha ankesat që ka pasur por përgjigja ka qënë sapo të kemi mundësi ne do e ulim në katet e poshtme, me vendimim të këshillit bashkiak nuk e mbaj mend saktësisht numrin e vendimit të 2021 sapo u liruan disa apartamente si këto u trajtua në një apartament dhome e kuzhinë me sipërfaqe 58 M2 famija e saj që përbëhet nga 3 anëtarë njëri është djali me aftësi që paguhet me kemp pa kujdestari dhe babai pra trajtohet me strehim sipas kushteve dhe rethanave që ka kjo familje në katin e parë të banesës me ashensor sipër është 58 M2 dhe është brenda noramve të strehimit, duke marrë shkas nga shapllja që bëme ne për apartamentet bosh për të cilat e kemi detyrim të jemi transparente pati kërkesë dhe aplikime edhe nga famija e cila plotësoi gjithë dokumentacionin ashtu siç e kërkonte ligji dhe në lidhje me përzgjedhjen e përfituesve nga ky program pasi bëhet listimi nga zyra nëpërmjet sistemit të pikëzimit zonja ka 24 pikë në kushte familjare 3 anëtarë nuk ka banesë kërkon zgjerim në kushte sociale me paftësinë e të birit me kushte ekonomike gati në përmbushje të kriterëve që ka ky program kap 24 pikë për tu trajtur tek apartamenti dy dhoma e një kuzhinë në katin e tretë mbi dyqane tek banesa që ne kishim bosh atëherë për të bërë përzgjedhjen u krahasuan kushtet ,rethanat e familjeve që mund të trajtoheshin tek ky apartament dhe ishte një familje e cila u

trajtua me zgjerim sepse ka në përbërje familjare 7 anëtare dhe jetonte në 45M2 tek banesat sociale me një anëtar me paaftësi dhe ajo dhe familja tjetër prej 4 anëtarësh e cila padiskutim kishte nevojë më emergjente për strehim sesa familja Dyli,ky ka qënë si të thuash analiza dhe vendimi që ka marrë komisioni i strehimit por kjo nuk do të thotë që në rastin më të parë që do të na jepet ne do kemi në përmbushje të kushteve të kësaj familje sepse nuk mund ta ngjitim ne katin e tretë ne e kemi provuar ajo ka qënë e trajtuar me strehim në katin e 8 te banesave sociale dhe e kishte të pamundur ne tani ta trajtojmë me zgjerim siç e kërkon zonja ku ne apartamentet që kemi janë ne katin e 3 mbi dyqane thënë ndryshe në katin e 4 dhe tjetri në katin e 5,kjo ka qënë analiza që ka bërë komisioni dhe e ka lënë në pritje për rastin më të parë që ne do kemi për një apartament që do të plotësojë kushtet e zonjës unë këtë sqarim kam ja kam thënë dhe zonjës dhe komisioni ka dalë me këtë arsyetim.

Kryetare e Këshillit A.Verushi: Ok,të dëgjojmë dhe plotësimin e fjalëve që ka qytetarja për të thënë dhe më pas fjala për këshilltarët.

Qytetarja: Kalova tek ajo shtëpi sepse unë e di si e zbrisja dhe e ngjisja,kalova nga e keqja sepse më tha doktori,kam 2 vjet që jam shpërngulur djali ska ikur asnjëherë nga shtëpia sepse ka ankth atje ku kam jetuar ka qënë kati i 4 dhe ai është ngjitur në këmbë kështu që ai nuk e ka idenë çfarë është ashensori,unë dua zgjerim për djalin që ai të jetojë sepse unë do plakem dhe skam ku ta le.

Këshilltar E.Bregu: Tani nga situata e paraqitur duket qartë që çështja është trajtuar fillimisht në mënyrë jo të drejtë duke bërë krahasimin e aplikantëve kjo çështje nuk mund të gjente zgjidhje me këto 3 banesa që mesa pashë dhe ato kati i parë ishte një banesë 1 plus 1 katet e tjera banesë 2 plus 1 por që ishin që nga kati i 5 dhe lart dhe ndoshta kjo nuk përmbush kriteret të cilat ka nevojë kjo familje por siç e thashë çështja në fillim fare është trajtuar gabim edhe dhe nuk janë marrë parasysh kërkesat sepcifike që duhet të ishin marrë.

Kryetare e Këshillit A.Verushi: Kjo periudhë ka kaluar tani ndonjë mendim tjetër sepse nuk duhet ti rikthehemi.

Këshilltar E.Bregu: Ajo që unë mendoj është se meqënëse për momentin nuk gjenden banesa të lira nga fondi i banesave ndoshta ne mund të miratojmë një fond shtesë që zonja të marre një apartament që i përshatatet asaj dhe duke liruar këtë banese që ka dhe ajo ti kalojë dikujt tjetër.

Drejtoresha e strehimit M.Balli: Zgjedhja që adresoni ju është dhënë dhe nga zyra jonë por ajo e refuzon.

Qytetarja: Po e refuzoj unë sepse unë kam 10 vjet ne bashki edhe nuk është gjetur zgjidhje.

Ekzekutivi M.Balli: Dua të shtoj dhe diçka tjetër atë që ju e diskutuat dhe si këshilltar ndoshta vërtet është trajtuar gabim nuk e di nga se ka ardhur por ajo është korigjuar në kohë,në momentin ku ne kemi siguruar një apartament në katin e parë dhe nuk është kërkuar zgjerim në atë kohë ne kemi të dokumentuar historikun e kësaj problematike. Nga ekzekutivi,nga bashkia dhe nga drejtoritë përkatëse në momentin më të parë të mundshëm është trajtuar si prioritet kjo familje tek apartamenti që është sot që është brenda normave të strehimit,është në katin e parë mos trajtimi në këtë rast nuk do të thotë që ajo humbet shanset,ne sapo të kemi një mundësi tjetër sepse ajo kërkon tek ky kontigjent ne patjetër do ta shikojmë me përparësi.Unë këtë shpjegim kam.

Këshilltar P.Tollkuci: E nderuar zonjë së bashku kemi folur në lidhje me këtë kërkesë unë shoh që ka pasur gjithmonë një dëshirë të mirë nga ana e ekzekutivit për tju ndihmuar,absolutisht siç është për të gjitha familjet që janë në nevojë dhe mesa ne dëgjojmë këtu në diskutim midis jush dhe këshilltarëve nuk ka munguar në asnjë moment dëshira për tju ndihmuar dhe padiskutim ne po dëgjojmë qartë nga ana e ekzekutivit që ju nuk do ju mohohet kjo e drejtë dhe do të përmbshet në 1 moment sapo të gjendet ai ambient të jetë e mundur si ju dhe djali juaj të keni akses sa më të lehtë në godinën tuaj,kështu që unë mendoj që dhe ne si këshilltarë të bëhemi pë të ndihmuar në bazë të kriterëve që përcakton ligji dhe si kundër ju jeni trajtuar deri më sot.

Këshilltare S.Dinellari: Së pari duket që problematika është për tu diskutuar nga të gjitha palët edhe nga drejtoria edhe nga ne si këshilltarë edhe nga zonja në fjalë por edhe nga përgjegjësit sepse aja ka arritur deri këtu nga ato që janë lënë bosh,unë mendoj që fillimisht ka një problem me çështjen ligjore të numrit të anëtarëve të familjes që ashtu siç thotë drejtoria ju jeni tre që ju pranoni që jeni katër gjë që ju e vërtetoni fare lehtë me çertifikatën familjare,problemi është që unë mendoj që duhet parë me prioritet është afati kohor sa do presë zonja sepse pritet 10 vjet u martua vajza do presim dhe pak dhe nuk i dihet çdo ndoshë me ligjin e natyrës dikush lind dikush vdes dhe pritshmëria e saj për tu zgjeruar sip e banesës është një pikëpyetje e madhe pra a ka një afat kohor sa duhet të presë zonja që të marrë një banesë në kushtet që ajo ka dhe a do të ketë një përgjigje se ka 10 vjet që pret dhe unë kuptova që dhe nga ana e atyre qe ka pasur përgjegjës ska marë asnjë përgjigje dhe do përgjigje nga drejtoritë përkatëse cilat janë argumentat që do ketë afat kohor.

Ekzekutivi M.Balli: Në lidhje me situatën dua të saktësoj 2 gjëra,ekzekutivi,drejtoria,bashkia është në përputhje me ligjin ajo zonjë nuk është jashtë ajo zonjë është strehuar në apartamentin 1 dhomë e 1 kuzhinë brenda normave të strehimit në lidhje me detyrimin moral mbetet ajo që kemi thënë sapo të kemi një mundësi mbetet zgjedhja e programit tjetër që është ajo e bonusit me qera ajo do gjejë 1 apartamanet që plotëson kërkesat dhe kushtet e saj dhe ne ta mbështesim me bonus qeraje në afatin më të shkurtër të mundshëm dhe pa asnjë lloj kufizimi, kjo është që kam për pyetjen e nështuar ne ligjërisht jemi shumë ok.

Këshilltar E.Bregu: Ajo është strehuar brenda normave të strehimit mund ta korigjosh pak këtë sepse nëse do ishte strehuar sipas normave nuk do të ishte këtu gjithë pretendimi këtu është që

ajo nuk është strehuar sipas normave për shkak të një gabimi ligjor në çertifikatë ajo nuk është brenda normave normale.

Ekzekutivi M.Balli: Edhe njëherë e theksoj se ligjërisht jemi shumë ok, nëse ju e shikoni dokumentacionin që ajo ka dorëzuar në çertifikatën familjare ka 3 anëtarë nëse flasim brenda normave të strehimit i referohemi akteve ligjore që sipas tyre kësaj familje i takon 50 deri në 60 M2 sip. funksionale, sip që ata banojnë është 58M2 dhe ne nuk ja kemi hequr të drjtën dhe shanin për tu trajtuar sipas kërkesës që ka por kushtëzohet nga rethanat në katin e 3 mbi dyqane dhe katin e 4 mbi dyqane do ketë probleme dhe prej saj do dëgjojmë përsëri të njëjtën koment ne kemi rastin e një familje që është në katin e 2 dhe ka një djalë mekarocë pra me aftësi ndryshe dhe vjen pranë zyrave tona dhe thot më gjeni një kat të 1 tek banesa me ashensor sepse kam të pamundur ta ngjit deri në katin e 2 ndërkohë ai ka bërë deklaratatë me shkrim dhe thotë jam dakort ta mar në katin e 2 sepse jam në nevojë emergjente pra ne që ndodhemi çdo ditë brenda situatave të tilla e vlerësojmë në një kornizë më të gjerë për të mos përsëritur problemin dhe gjetur zgjidhje stabël.

Kryetare e Këshillit A.Verushi: Edhe njëherë fjala për ju zonjë.

Qytetarja : Kur janë dhënë ato pallate kam qënë 4 veta ndërkohë dhe ti do bazohesh në ajo çertifikatë që unë kam hyrë sepse nuk trajtohen ata që janë të sëmurë dhe unë nuk e le atë fëmijë të vuajë.

Kryetare e Këshillit A.Verushi: Besoj se të gjithë këshilltarët janë në të njëjtin mendim duke dëgjuar problemin e zonjës por edhe mundësitë e ekzekutivit ofrimet që bën ekzekutivi sot për atë çka ka, ne do të jemi të ndjeshëm sepse sot nuk mund ti japim zgjidhje por një nga çështjet emergjente do të jetë pikërisht kjo për të gjetur një konsensus sepse është e rëndësishme të kemi dhe konsensus me zonjën në fjalë besoj se edhe drejtorja e ka vetë në shqetësimin më të madh sepse ka shumë problematika. Faleminderit zonjë për shqetësimin në na ke bashkë me shqetësimin tënd.

Ka ndonjë qytetare tjetër që do të marrë fjalën?

Qytetarja 2 : Unë kam kërkuar dhe këshillit bashkiak dua topograf të jetë i bashkisë dua edhe 2 persona nga këshilli bashkiak që ta shohin të vërtetën, jemi 2 pensionista burri 78 dhe unë 78 nuk është gjynah unë kam 5 vjet që nuk hy dot në zyrën e kryetarit të qaj hallin të tokave jemi shumë të shqetësuar unë dua që të dalë e vërteta nuk them që ai djali topograf ishte i keq. Unë kam vetëm 27m 80M2 le tja japë bashkia kujt të dojë për mua të më hapet prona të suvatoj shtëpinë.

Këshilltare A.Taho: Në rast se kemi konflikte të tilla si i zonjës që ekziston midis zonjës dhe komshiut që janë të dyja pona private kopetencat që ligji i njeh njësisive vendore është që të shkojë të bëjë matjet administratori i rajonit i thëret të dyja palët i fton ta zgjidhin me marveshje dhe në rast se nuk zgjidhet me marveshje ti drejtohet rrugës gjyqësore. Në rastin e zonjës kemi marrë informacion nga AKSH-ja na është dhënë në dispozicion edhe dokumenti i pronësisë së

zonjës dhe komshiut janë bërë matjet në vend dhe ka rezultuar ajo që zonjës nuk i pelqen pra topografi ka bërë matjet ka matur sip e komshiut dhe të zonjës janë thirur të dyja palët nuk e kanë zgjidhur me marveshje atëherë mbetet që konflikti të zgjidhet në rrugë ligjore domethënë deri këtu ka kompetenca njësia e qeverisjes vendore i ftoi palët ta zgjidhin me marveshje konfliktin nëse nuk e zgjidhin i drejtohen gjykatës.

Këshilltari S.Dinellari: Problematika qëndron midis 2 pronave për çështjen e sipërfaqes, ju keni vetëm këtë problematike apo pjesën tjetër që tha zonja sepse drejtoria përkatëse nuk mund ta lejoje këtë shtëpi të bjerë sepse zotëria po thotë më pikon muri, problematika qëndron vetëm për çështjen e sipërfaqes apo dhe për çështjen e mirëmbajtje.

Kryetari e Këshillit A.Verushi: Nuk e ka për mirëmbajtjen e ka për sipërfaqen.

Nënkryetari K.Kita: Kërkon ti lirohet prona nga një pronë private që si është rregjistruar kjo nuk është kompetencë e bashkisë, ka bërë identifikimin topografi bashkë me inxhinierët përkatës.

Kryetari e Këshillit A.Verushi: Nuk është kompetencë e bashkië sepse janë dy prona private është mes jush, këshilli bashkiak meret vetëm me pronat shtetërore jo me pronat private sepse nuk mundemi të ndërhyjmë.

Nënkryetari K.Kita: Zonja kryetare më kupto pronat private si timen dhe të asaj do i ndjek me gjyqë por kjo pronë është pronë bashkie.

Këshilltari I.Bode: Zonja thotë që është kufizim me pronë bashkie.

Nënkryetari K.Kita: Tani është marrë informacioni nga zyra e rregjistrimit dhe e ka nxjerë zyra e rregjistrimit në thjeshtë kemi bërë në bazë të hartës që kanë dërguar, nga zyra e rregjistrimit kemi marrë informacion për të dyja shtëpitë nga kufizohet dhe sa sipërfaqe kanë kemi bërë verifikimin me topografin kemi cuar një hartë zonjës që nuk është as e bashkisë as e shtetit është pronë private tani sesi janë bërë ato nuk është kompetenca tonë.

Qyetarja 2 : Zoti nënkryetari e ke gabim për këtë gjë ajo nuk ka pronë 250M .deri tek muri tim sepse asnjë njeri nuk të le kur mer leje ndërtimit ti ngjitesh tjetrit në mur.

Nënkryetari K.Kita: Ju e keni dosjen atje të dokumentacionit nëqoftëse ndonjë nga këshilltarët do ti shikojë mund ti shikojë atje.

Kryetari e Këshillit A.Verushi: Atëherë edhe njëherë edhe nga fjala që kanë marrë këshilltarët unë po kuptoj të gjithë jemi në të njëjtin mendim duke dëgjuar dhe ekzekutivin nuk është kompetencë e këshillit bashkiak për tu marrë me këtë lloj kërkesë apo shqetësimi që ju keni, atëherë

kalojmë në një kërkesë tjetër që ka erdhur nga adresën time por që i adresohet në të njëjtë kohë këshillit,uroj që ky email tju gjejë mirë në cilësinë e drejtoreshës të ekzekutivit dhe të shoqatës për autonome vendore nëpërmjet këtij email ju informoj mbi procesin e integritetit të strukturave dhe njësisve vendore dhe mbi rëndësinë e në lidhje me komisionin e integritetit europian të strukturave të bashkisë procesi i përfshirjes të qeverisjes vendore në proceset e integritetit europian të shqipërisë tashmë ka filluar të realizohet edhe mbi bazën me të konsoliduar institucionale e bazuar në eksperiencën e fituar si dhe në zbatimin e vendimit të këshillit të ministrave numer 450 datë 29.07.2018 përbashkë rendimin dhe kordinimin e procesit të integritetit europian nëpërmjet qeverisjes qendore dhe njësisve të qeverisjes vendore konstatohet që ende proceset që kemi lidhen me integritetin euopian nuk janë bërë pjesë e politikave apo vendimarrjes lokale,për këtë arsye avancimi dhe detyrimi i të gjitha detyrimeve ligjore të shtetit dhe autoriteteve shqiptare kërkon domosdoshmërisht që kjo detyrë e ngarkuar për bashkinë të ngrihet në një nivel të një funksioni nga ana e bashkive dhe këshillave bashkiak duke përfshirë këtë proces në rregulloret tuaja me ngritjen e komisionit të integritetit, ju lutemi kemi bashkëlidhur një dokument rekomandues për ngritjen e komisionit të përfshirjes të objektit të tij në rregulloren e këshillit bashkiak, ju faleminderit për bashkëpunimin.Unë do tju sygjeroja komisionit të rregullores të marrë këtë material rekomandues të bëjë ndryshueshmërin e nevojshme në rregulloren e këshillit bashkiak dhe më pas të sjell këto ndryshime këtu për tu miratuar dhe për tu ngritur ky komision i integritetit krahas komisioneve të tjera,kështu që komisioni i rregullores do të jetë i lutur që pranë sekretariatit të marrë rekomandimet që kanë erdhur dhe për ti replikuar ato në rregullore dhe hapur rrugë ngritjes të këtij komisioni.Kanë ardhur disa kërkesa po lexoj njëren që ka ardhur nga Elvini pasi është vënë në dispozicion lista e të punësuarve në bashkinë Korçë dhe disa ndërmarjeve në të cilat bashkia është aksionere si dhe anëtarë që marrin pjesë në bordin drejtues kërkojmë futjen në rendin e ditës për diskutim në mbledhjen e radhës të këshillit bashkiak në mbledhjen e radhës tetor 2023,kjo është e tejkualuar dhe besoj se të gjitha këto kërkesa të listimeve të të punësuar duhet tji vijjë ashtu si kemi folur,po lexoj edhe tjetrën në disa zona lejohet parkimi vetëm për rezidentët besoj se do të ishte mirë që ndalimi për të parkuar për jo rezidentët të jetë vetëm në një fashë kohore dhe jo ndalimi 24 orë pra gjatë ditës nga ora 8 deri në 16 :30 orari i punës të lejohet të parkojnë dhe jo rezidentë për shkaka se sepse në këto zona ka dhe aktivitete biznesi dhe të gjithë kanë nevojë për parkim si biznesmenet dhe punojësit ndërkohë që banorët rezidentë gjatë kësaj kohe kanë ikur në punë dhe mund të kenë nevojë të parkojnë në një tjetër zonë ku lejohet parkimi vetëm për rezidentët.

2. Transport publik nuk ka në të gjitha zonat rurale,ndaj duke pasur parasysh që bashkia duhet tju shërbejë të gjithëve duhet të sigurohet transporti publik në këto zona dhe në orare të përshtatshme që i shërbejnë komunitetit, në zonat rurale nuk u njihen benefitet për transport publik pensionistëve dhe kategorive të tjera që trajtohen me këto benefite ashtu siç u njihen në zonat brenda qytetit.

3.Shtëpia e Naum Verqilagjit në Vithkuq është rënuar si një nga patriotët më të mëdhenj të këtij vendi besoj se duhet të meren masa që të ringrihet kjo shtëpi por edhe të tjera të kësaj kategorisë

që mund të shërbejnë si atraksion turistik për zonat në të cilat ndodhen. Unë mendoj që meqënëse kryetari nuk është unë do ja ve në dispozicion këto dhe në mbledhjen e radhës dhe të merni përgjigje për të gjitha këto sepse jo çdo gjë do të varet nga përgjigja jonë apo edhe përfaqësuesve të ekzekutivit këtu. Ka dhe një kërkesë tjetër nga Laureta Alidinaj. Referuar stuhisë të fundit janë djegur rreth 860 moden kompjuterash dhe shumë televizorë në qytetin e Korçës kërkoj të planifikohet një fond në buxhetin e ardhshëm për vendosjen e një rufe pritëse në qytet që situata të mos përsëriten edhe për këtë në përsëri do të marim një përgjigje nga kryetari i bashkisë sepse ka procedura që nuk e dimë se si dhe ku është e lejueshme. Ka dhe një kërkesë tjetër .

Këshilltar E.Bregu: Jam dakort që këto kërkesa që ne kemi kërkuar ti kalojmë në seancën tjetër ku të jetë kryetari prezent por do ishte mirë që kur vjen informacion elektronikisht dhe këto kërkesa të përfshiheshin aty që këshilltarët e tjerë të jenë të njohur me çështjen.

Kryetare e Këshillit A.Verushi: Ok ke të drejtë, patjetër.

Nuk po ju citoj të gjithë kërkesën por vetëm thelbin e saj nga zoti Agron banor i fshatit Goskov aty besoj që secili e di ka një lokal aty në kthesa sa hyn në ura ai kërkon që ti jepet me qera apo të marë si pronë dhe të shkojë drejt kufizimit të pronës të tij ti shkojë deri tek burimi i ujit ose le të themi deri tek vija ujore që kalon aty para godinës të tij në mënyrë që të zgjerojë aktivitetin dhe të nxjerë tavolina, unë nuk e di sa e lejueshme është që bashkia ti jap në pronësi këtë pjesë në dijenin time duhet të ketë largësi.

Këshilltar E.Bregu: Shiko unë e njoh këtë problematikë aty është një përuea dhe ai do të zgjerojë aktivitetin ndërkohë që banorët e fshatit nuk janë dakort.

Këshilltar I.Bode: Nëse diçka është e shkruar dhe kërkesat janë të dokumentuara atëherë ti marim parasysh dhe të fillojmë ti shqyrtojmë por nëse vijmë thjesht me unë di që ka këtë po humbim kohë në mbledhjen e kësajll bashkiak nëse ka diçka dhe zotëria kërkon ti privatizohet ashtu si është ligji me dokumenta dhe të shqyrtohet nëse nuk bëhet nuk bëhet edhe kundërshtimi i komunitetit këto janë gjëra që flasin letrat, letra nuk kemi kot sa e trajtojmë.

Kryetare e Këshillit A.Verushi: Ju lutem më thuhet nga sekretaria që komisioni i integritetit europian është me përberjen e Znj. Ada Përmeti, Zoti Joan Deli, Znj Alma Burda, Zoti Devis Osman, mos e duan të veçuar do ta sqarojmë me Adelinën dhe me pas.

Këshilltar E.Bregu: Në muajin qershor e kemi bërë një kërkesë të freskët për pajisjen me zyra të partisë demokratike sipas ligjit për partitë politike ndërkohë që nga bisedat e bëra me kryetarin ka 6 vjet që kërkohen zyra dhe ende nuk është zgjidhur situata në përgjigje të shresës që ne kemi bërë kemi mar përgjigje që duhet të plotësojmë disa dokumenta të cilat nuk është e drejtë të na kërkohen ne sepse ato dokumenta janë publike në përsëri i kemi plotësuar ndoshta mund të

mungojë një dokument por ajo që dua të theksoj unë është proceduar, kryetari kërkesën duhet ta paraqesë në këshill nuk mund të vendos ai na takon ne ose jo, kërkesa është protokolluar ai është menaxheri i bashkisë vendimarrësi jemi ne, ndaj kërkoj që kjo kërkesë të paraqitet në këshill në një të ardhme sa më të afërt ndoshta mund të jetë me vend të kërkohej një seancë jashtë radhe për tu trajtuar kjo çështje apo edhe të tjerat.

Këshilltari A.Taho: Procedura sesi jepet zyra me qera është e përcaktuar me vendimin e këshillit të ministrave në bazë të secilit pasi subjekti politik paraqet kërkesën në bashki zyra përkatëse që merret me menaxhimin e pronave verifikon nëse ka objekte të lira për partinë politike ose për qëllim nëse ka zyra të lira i çohet kryetarit relacioni dhe i thuhet paraqite në këshill që këtë objekt tja japim subjektit që e ka kërkuar nëse nuk ka atëherë çfarë material do sjellë kryetari në këshill.

Këshilltari E.Bregu: Po ka zyra të lira, për shembull ish bashkia e vjetër ka zyra të lira.

Kryetari e Këshillit A.Verushi: Nuk ka zyra të lira sepse atje e di unë situatën si është.

Këshilltari E.Bregu: Ka zyra sepse mund të lëvizin, ndërkohë tek shtëpia e oficerave në kat të 4 janë dhënë zyra për kërkim zhvillim universiteti, para 2 vitesh janë dhënë këto zyra dhe prej një viti ato nuk funksionojnë, kështu që i kërkoj bashkisë dhe ekzekutivit të kërkojë më mirë se mbase gjen dhe ta paraqesë në relacion.

Këshilltari A.Taho: Në momentin që ka objekte të lira keni të drejtë të kërkonit subvencionim e qerasë.

Këshilltari E.Bregu: Ne e dimë ligjin e dimë dhe VKM-në e firmosur nga ministrja në muajin prill të 2023 kështu që jemi në dijeni dhe kërkoj të merren masa sa më parë.

Kryetari e Këshillit A.Verushi: Edhe diçka tjetër nga këshilltarët meqënëse ende nuk e kemi administruar të plotë listën që do të jenë pjesë e ekskursionit në bashkinë Shkodër dhe lezhë besoj ka qënë koha e mjaftueshme për të bërë axhendat personale dhe nëse ka ende këshilltarë që duan të bëhen pjesë të jenë pranë Evës, dhe diçka tjetër që unë kam grupi i grave anëtare të këshillit do të jetë nesër një biznes në kuadër të tetorit rozë si mbështetje solidarisimi në lidhje me problematikat e kancerit të gjirit bashkë me ne do të jenë dhe mjekë specialiste do të mundësojmë që një pjesë e grave të këtij biznesi të shkojnë të bëjnë mamografinë do të jetë 2 opsionalitete një opsionalitet për tu bërë falas sepse mamografitë dhe nëse nuk do të arrijmë brenda këtij kufiri kohor do të mundësojmë që nëpërmjet një pagese me vullnetin tonë të lirë me mamografinë e përgjithshme për të bërë diagnostikimin Ada është interesuar për këtë pjesë ka komunikuar me biznesin e Tona kompani dhe ne do të jemi nesër në orën 12 aty nuk është e thënë që vetëm gratë e albaneset edhe burat sepse kjo problematike shqetësuese vlen edhe ne familje.

Këshilltare L.Alidinaj: Të respektohen afatet ligjore në lidhje me hartimin e projektbuxhetit afatmesem të bashkisë, draftbuxheti nuk është vënë ende në dispozicion nuk është shpallur ende kalendari i plotë i datave dhe as nuk janë njoftuar palët për këtë proces, të krijohen kushte për pjesmarrjen e publikut në dëgjesa dhe mos bëhet ajo vetëm me anëtarët e bashkisë, dhe nënpunës të administratës , të sigurohet sipas ligjit roli drejtues dhe nismëtar i këshillave për procesin e konsultimit duke u mbështetur me mjetet e duhura financiare dhe infrastrukturës, gjithashtu të reflektohet buxheti tek faqet e WEB-it të Bashkisë,këshillit në mënyre që qytetarët të jenë të informuar se çfarë u pranua nga propozimet e tyre prej këshillit, të vihet në dispozicion projekti afat mesëm për qytetarët para dhe pas miratimit të këshillit për të parë ndryshimet pas konsultimit me qytetarët, të krijohen vendparkime në qytet,të ngrihet një rrufepritëse në qytetin e Korçës, ndërtimi i ashensorëve në pallatet shumëkatëshe, të vendosen në dispozicion ambiente të cilat do të shërbejnë si zyra për partinë demoratike, të përcaktohet dita e diel pushim për bizneset.

Nënkryetar K.Kita: Ligji thotë që ju si këshilltarë duhet ti organizoni.

Këshilltar E.Bregu: Pyetjet i drejtohen kryetares të këshillit jo ekzekutivit.

Kryetare e Këshillit A.Verushi: Ka një buxhet i cili do të jetë buxheti i këshillit dhe i buxheti i këshillit detajohet dhe vendoset për miratimin tonë.

Këshilltar E.Bregu: Kur vendoset ai?

Nënkryetar K.Kita: Kur të miratohet tani buxheti do të miratohet, vitin e kaluar e kemi miratuar.

Këshilltar E.Bregu: Ne jemi duke u marrë me projektin duhet të vijë i shkëputur se smund të lexojme gjithë buxhetin ne vetëm për këtë pjesë.

Nënkryetar K.Kita: Duhet ta lexosh sepse duhet ta miratosh atë.

Këshilltar E.Bregu: Ky është miratuar nga viti i kaluar çdo lexoj unë tani, ky buxhet që thua ti për të marrë pjesë në këshillat është miratuar vitin e kaluar dhe ne po e përdorim tani kurse ai që do miratojmë ne është për vitin e ardhshëm dhe na vër në dispozicion atë të kaluarin për të parë sesi është bërë miratimi.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Nëqoftëse e lexon hyn tek faqja e WEB-it të Bashkisë ke një platformë e cila është vetëm për këshillin.

Këshilltar E.Bregu: Ju vihen në dispozicion gjithë qytetarëve njoftimet vendi ku do të mblidhen ju krijohen kushtet dhe këshilltarëve ju krijohen kushtet e duhura për të shkuar. E ke bërë pikën e fundit po pyet nënkryetarja e këshillit ?

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Po, njoftimet ju kanë edhur në grup. Kur të bëhet në qytet do ju vijë njoftimi përsëri.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva Naçi

**KRYETARE
ANA VERUSHI**